

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 589 Prot.

Tiranë, më 03.062016

VENDIM Nr. 50, datë 20.05.2016

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë"(i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.6 të datës 20.05.2016, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor në vazhdim "Maligradi"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Dr. Petrika Lera (IA) dhe Adj. Prof. Stavros Oikonomidis (Institutit i marrëdhënive ndërballkanike kulturore, Athinë),

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor në vazhdim "Maligradi"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, bashkëdrejtues Prof. Petrika Lera (IA) dhe Prof. Stavros Oikonomidis (Institutit i marrëdhënive ndërballkanike kulturore, Athinë), në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:
 - Vazhdimin e gërmimeve në sektorin A3, ku janë zbuluar për herë të parë materiale të periudhës së bronzit të hershëm.
 - Sektori A1 dhe Sektorin A2, ku janë zbuluar materiale që lidhen me antikitetin e vonë dhe mesjetën.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë qershor 2016.
3. Gjetjet e përfituara nga gërmimet e mëparëshme të depozitohen pranë fondeve të IA Korçë.
4. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO